



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 4 prot.

Kamëz, më 22.01 2024

V E N D I M

Nr 04 Datë 22 / 01 / 2024

M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA ADMINISTRATORËT SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.01.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.01 Datë 11.01.2024 mbështetur në Ligjin 57. Date 18.07.2019 ”Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore” Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të ndryshuar kreu IV, pika 3, Vendim 868, datë 29.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.597 date 04.09.2019 dhe në VKB nr. 04 datë 23.01.2023 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”. **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së muajit **Dhjetor 2023**, prej **63 familje** që janë rekomanduar nga administratorët shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.
Fondi për këto familje është **311,768 (treqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.**
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi paraqitet në relacionin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hyşen KOLDASHI

